Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE²

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

² Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE³

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

³ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (të ndryshuar), kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Higjenizues me bazë hipoklorit kalciumi. {*Calcium hypochlorite (Ca(OCl)₂)* CAS no.7778-54-3} në përqendrim 30%-40%; Ky preparat duhet të shërbejë për higjenizimin e ambjenteve dhe ujrave të ndotura. Paketimi: Në konfeksion plastik 20kg-50kg dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

2. Higjenizues me bazë hipoklorit natriumi. {*Sodium hypochlorite (Na OCl)* CAS no.7681-52-9} në përqendrim 12%-15%. Ky preparat duhet të përdoret për higjenizimin e tualeteve, myshkut, algave dhe si preparat për higjenizimin e sipërfaqeve dhe pajisjeve të ndryshme. Paketimi: në konfeksion plastik 5 deri 25 litra dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

3. Higjenizues me bazë komponime të amonit kuaternar. Ky preparat duhet të përdoret për higjenizimin e ambjenteve të jashtme dhe të brendshme, i përshtatshëm për pajisjet spërkatëse të tipit ULV (mjegulluese) dhe pompat me presion të ulët. Spektri i veprimit të preparatit të përfshijë eliminimin e viruseve, baktereve, kërpudhave dhe mykut. Lëndët bazë aktive e këtij preparati higjenizues duhet të jenë komponime të amonit kuaternar, dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit. Preparati të jetë në formë të lëngshme dhe i tretshëm në ujë. Destinacioni i përdorimit: Në ambiente të brendshme dhe të jashtme si zyra, qendra sociale, shkolla, kopshte, rrugë, sheshe publike, vendgrumbullime

mbeturinash, holle të hapura, sheshe pushimi, ambiente pritje jashtë, rrugica hyrëse-dalëse, mure të jashtme godine, mure rrethuese. Paketimi: në konfeksion plastik 1 deri 5 litra dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se $\frac{1}{2}$ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

4. Adulticid për luftimin e grerëzave në fole në formë shkume. Ky produkt të jetë i gatshëm në formën e bombulave për spërkatje në formë spraji me efikasitet minimumi deri në 3 metra, për luftimin e grerëzave direkt në foletë e tyre. Valvula speciale e dërgon produktin në formë sprucimi dhe sapo godet folenë ai shndërrohet menjëherë në një shkumë të dendur dhe mbështjellëse që pengon insektet të fluturojnë duke realizuar në një kohë të shkurtër eliminimin e tyre. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë adulticid i klasës Piretroide dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit. Paketimi: Në konfeksion metalik me mekanizëm sprucimi në formë aerosoli 500ml-1000ml. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se $\frac{1}{2}$ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

5. Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse si milingona, miza, pleshta, rriqna, morra, për ambjente të jashtme të godinave publike, arsimore, parqet publike, kanalizimet. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë të klasës Piretroide në formë mikrokapsulare me efekt të menjëhershëm dhe të zgjatur. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtatshëm për pajisjet dezinfektuese per pompat me presion të ulët. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Duhet të ketë efekt të menjëhershëm godites dhe toksicitet të ulët/mesatar. Paketimi: Në konfeksion plastik 100 ml - 1 lt. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se $\frac{1}{2}$ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

6. Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse milingona, miza, pleshta, rriqna, morra, për ambjente të brendshme të godinave publike, arsimore, bodrumet, vendstrehimet. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë të klasës Piretroide në formë e mikrokapsuluar te gatshme pa pasur nevojën e shtimit te preparateve te tjera per te patur nje efekt të zgjatur. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtatshëm për pajisjet dezinfektuese dhe i pershtatshem per pompat me presion të ulët. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Duhet të ketë efekt të menjëhershëm dhe toksicitet të ulët/mesatar duke mos lënë mbetje pas përdorimit. Paketimi: Në konfeksion plastik 100 ml -1 lt. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se $\frac{1}{2}$ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

7. Insekticid për luftimin e furrtaeve. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë Imidaklopid në trajtë xheli. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit i ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Paketimi: Në konfeksion plastik në formë shiringe jo më shumë se 50g. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se $\frac{1}{2}$ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

8. Rodenticid për luftimin e minjve në mjedise të hapura dhe të mbylluara. Ky preparat duhet të jetë i tipit pellet, pastabite ose block. Për të shmangur rezistencën ndaj rodenticiteve Antikoagolante lënda bazë aktive e rodenticidit duhet të jetë e klasës jo-Antikoagulante dhe vecanerisht efektiv ndaj Miut Norvegjes (*Rattus norvegicus* Berkenhout) dhe Miut të shpise "*Rattus rattus*" me veprim të ngadalshëm ose kronik. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar i parrezikshëm për mjedisin. Paketimi: Në konfeksion plastik 0.1kg - 5kg i ndarë në copa nga 15-20g secila. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se $\frac{1}{2}$ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

9. Test nje perdorimsh i shpejte per evidentimin e prezences se cimkave te shtratit (*Cimex lectularius*) me efikasitet evidentimi jo me te ulet se 90%. Shpejtesia re rrezultatit te testit nuk duhet te jete jo me i vone se 10 min nga marrja e mostres.

10. Rodenticid për luftimin e minjve në mjedise të hapura dhe të mbylluara. Ky preparat duhet të jetë i tipit pellet, pastabite ose block. Lënda bazë aktive e rodenticidit duhet të jetë e klasës Antikoagulantë me veprim të ngadalshëm ose kronik. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar i parrezikshëm për mjedisin. Për të evituar kontaktin rodenticidit me gjallesat e tjera përveç minjve dhe për t'i ruajtur nga agjentët atmosferikë duhet të jenë të veshuara me një shtresë e cila të jetë hidhëruese me anë të lëndëve aktive si Bitrex (*denatonium benzoate*, CAS no. 3734-33-6) ose ekuivalentin e tij të destinuar për këtë qëllim. Paketimi: Në konfeksion plastik 0.1kg - 5kg i ndarë në copa nga 10-15g secila. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se $\frac{1}{2}$ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

11. Preparat repelent për largimin e gjarpërinjve dhe zvarranikëve. Ky preparat duhet të jenë i tipit repelent me formulim granular. Lënda bazë aktive e repelentit duhet të jetë natyrale e përbërë nga lloje të ndryshme vajrash bimorë e cila kur aplikohet krijon efekt mjedisi të papëlqyeshëm për zvarranikët, veçanërisht tek gjarpërinjtë dhe është e padëmshme për njerëzit, kafshët dhe shpendët. Paketimi: Në konfeksion plastik ose metalik 0.5-2 litra. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se $\frac{1}{2}$ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Të gjitha paketimet e preparateve objekt prokurimi duhet të jenë të etiketuara në gjuhën shqipe referuar nenit 1 pika 1.2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.488, datë 29.06.2016 "Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve", pikës 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.487, datë 29.06.2016 "Për klasifikimin e produkteve biocide" dhe nenit 8 të Ligjit Nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia
1.	Hipoklorid kalciumi	kg	1,500
2.	Hipoklorid natriumi	litër	286
3.	Higjenizues me baze komponime te amonit kuaternar	litër	2,000
4.	Adulticid per luftimin e grerezave ne forme shkume	cope	600
5.	Insekticid kundra insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të hapura	litër	2,680
6.	Insekticid kundër insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të mbyllura	litër	860
7.	Insekticid kundër furrtareve	kg	30
8.	Rodenticide kundra brejtësve Jo-Antikoagolante	kg	200
9.	Test 1 perdorimesh per evidentimin e cimkave te shtratit (cimex Lectularius)	cope	100
10.	Rodenticide kundra brejtësve	kg	1,526
11.	Preparate për largimin e gjarpërinjve	litër	1,100

Afatet e lëvrimit:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	Afati i lëvrimit
1	Hipoklorid kalciumi	kg	1,500	6 muaj
2	Hipoklorid natriumi	litër	286	6 muaj
3	Higjenizues me baze komponime te amonit kuaternar	litër	2,000	6 muaj
4	Adulticid per luftimin e grerezave ne forme shkume	cope	600	6 muaj
5	Insekticid kundra insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të hapura	litër	2,680	6 muaj
6	Insekticid kundër insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të mbyllura	litër	860	6 muaj
7	Insekticid kundër furrtareve	kg	30	6 muaj
8	Rodenticide kundra brejtësve II	kg	200	6 muaj
9	Test 1 perdorimesh per evidentimin e cimkave te shtratit (cimex Lectularius)	cope	100	6 muaj
10	Rodenticide kundra brejtësve	kg	1,526	6 muaj
11	Preparate për largimin e gjarpërinjve	litër	1,100	6 muaj

Shpjegim i termave: **DPOP** → Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

2.1.3 Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.1.4 Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë çertifikatat ISO të kërkuara janë të detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të çertifikuara nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit. Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit nga Drejtoria Rajonale Tatimore ku ushtron aktivitetin. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

***Shënim:** Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme ku shumatorja e vlerave për furnizimet e ngjashme të jetë minimalisht **20 670 156 (njezet milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e njeqind e pesëdhjetë e gjashtë) Lekë pa Tvsh**, që përbën 39% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; **a)** Vërtetime të lëshuara nga një ent

publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, **b)** Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF), ose autorizim prodhuesi/distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit. Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje/bashkëpunimi të vlefshme, midis prodhuesit dhe distributorit ose çdo akt tjetër që prodhuesi i një produkti i jep të drejtën e tregtimit një kompanie tjetër. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi produkte insekticidë, adulticidë dhe rodenticidë (*produktet me Nr.3,4,5,6,7,8, dhe 10 në tabelën e Shtojcës 7*), duhet të paraqesë autorizim për bërjen të disponueshme në treg ose autorizim importi të produkteve biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas legjislacionit në fuqi.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues për të gjitha mallrat objekt prokurimi, duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe mënyrën e përdorimit të produkteve. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi, insekticidë, adulticidë, rodenticidë, repellentë dhe higjienizues (*produktet me Nr.1,2,3,4,5,6,7,8,10, dhe 11 në tabelën e Shtojcës 7*), duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar/publikuar nga prodhuesi/it.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose qira të paktën 1 (një) automjet ATP (automjet i transportit të përzier) me karrocë të mbuluar. Për këtë duhet të paraqesë, Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin të vlefshme, ose në rast se e merr automjetin me qira të paraqesë kontratën e qirasë dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin) të vlefshme.

Shënim: Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion në

paketim origjinal dhe etiketim sipas percaktimeve te legjislacionit shqiptare për produktet objekt prokurimi. Mostra e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se: Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁴. Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me: a) çmimet; b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose, d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë. Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.
--

C: DEKLARATA

⁴ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
